

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksion i Varrezave te Qytetit”. Bashkia Peqin

VLERA E FONDIT LIMIT: 7,598,015 (shtatëmilion e pesëqind e nëntëdhjetë e tetëmijë e pesëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor Këshilli i Qarkut Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP nr.162 datë 23.12.2020, (i ndryshuar) si dhe në nenin 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 83 të LPP, (i ndryshuar) dhe në nenin 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...” “...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2.1 Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë të cilësisë së punimeve **ISO 9001 (e vlefshme) ose ekuivalente**.

(Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO ndërkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 14001 (e vlefshme) ose ekuivalente**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO ndërkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 45001 (e vlefshme) ose ekuivalente**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO nderkohe që secili operator ekonomik

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (**2021,2022,2023**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe tekontabilistit te miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt- ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatuashme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertuesgjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2021,2022,2023**), lëshuar nga Administrata Tatimore, ku vlerat xhiros për të paktën një nga vite e periudhës së kërkuar duhet të jete jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

2.2.3.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet që dëshmojnë se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2024 sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr.9632/2006 “Per sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar).

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Kriteri sipas pikës 2.2.3 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit ku operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitet 2023, 2024 sipas parashikimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006. Operatori ekonomik i kualifikuar i

pari në klasifikim duhet të dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore“ (i ndryshuar), neni 5, pika ”c”, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të percaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2021 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

- Për kontrata për punë publike të realizuar me institucione shtetërore kërkohen:

a. Kontraten/at e Sipërmarrjes, b. Situacion përfundimtare të objektit,

c. Faturat tatimore për çdo situacion,

d. Formular Vleresimi nga Investitori

e. Akti i Kolaudimit,

f. Certifikata e marrjes në dorezim

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

Kontratën e bashkimit të operatorëve ekonomik dhe prokurën e posaçme si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit;

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), parashikohet se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Gjithashtu Autoriteti Kontraktor në funksion të kërkesës për të provuar përvojën e mëparshme të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit ka kërkuar që në rastin e paraqitjes së punëve të ngjashme me kontrata bashkëpunimi ku operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë një përqindje të caktuar dhe zëra specifikë të punës në tërësi ka kërkuar si dokumentacion shoqërues dhe **kontratën e bashkëpunimit dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit.** Sqarojmë se për të vërtetuar faktin nëse ky operator ekonomik përmbush punët e ngjashme të kërkuara ky dokumentacion është i nevojshëm për autoritetin kontraktor. Në mbështetje të Nenit 88 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), aktet ligjore parashikojnë formën dhe dokumentacionin e nevojshëm për të ofertuar si bashkim operatorësh ekonomik (kontrata e bashkëpunimit si dhe përcaktohen elementet konkrete që do të kryejë secili prej operatorëve ekonomik në bashkëpunim). Pra referuar këtij dokumentacioni përcaktohet saktësisht përqindja dhe elementët konkretë në zëra punimesh që operatori ekonomik ka marrë përsipër të realizojë në këtë kontratë duke i krijuar mundësi autoritetit kontraktor të verifikojë dhe vlerësojë nëse punimet e marra përsipër për tu realizuar në këtë kontratë janë të ngjashme me punimet e kontratës objekt prokurimi. Thënë kjo operatori ekonomik mund të plotësojë vlerën në përqindje të punës që kërkohet të realizohet por ndërkohe në kontratën e realizuar në bashkëpunim mund

të mos ketë realizuar zëra të ngjashëm me kontratën objekt prokurimi duke mos provuar përvojën e suksesshme për punë të ngjashme.

Gjithashtu ne kontratat e lidhura si nënkontraktor është kërkuar kontrata bazë ndërmjet kontraktorit dhe Autoritetit kontraktor si dhe miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga autoriteti kontraktor. Referuar Nenit 126 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 pika 3 përcaktohet se autoriteti kontraktor përpara lidhjes së nënkontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike miraton nënkontraktorët e mundshëm. Çdo nënkontraktim që nuk lidhet sipas kësaj dispozite nuk është i vlefshëm dhe nuk mund të vlerësohet nga autoriteti kontraktor si pune e ngjashme pasi bie ndesh me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik. Nisur nga këto dispozita ligjore autoriteti kontraktor ka kërkuar dokumentacionin e nevojshëm për verifikimin dhe vlerësimin e punëve të ngjashme të realizuara nëpërmjet kontratës me nënkontraktim.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin emiratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores përkriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Punime të Përgjithshme Ndërtimi

- NP.1 A, Punime gërmimi në tokë
- NP.2 A, Ndërtime civile dhe industrial
- NP.4 A, Rruge, Autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.

Punime Speciale Ndërtimi:

- N.S-1 A, Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S -4 A Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to, rifinitur me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukurës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kushtskualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar) dhe nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), si dhe si dhe në VKM nr 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” (i ndryshuar).

Gjithashtu në mbështetje të Ligjit specifik nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (i ndryshuar), nëni 8 përcaktohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit, në përputhje me standardet kombëtare ose europiane... .”

Kategoritë për punimet e ndërtimit dhe niveli për çdo kategori punimesh zbatimi janë përcaktuar referuar zërave të preventivit të punimeve për këtë objekt, projektit të zbatimit si dhe në mbështetje të plotë të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, (i ndryshuar).

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP 1	Punime gjurmimi në tokë.	Punime gjurmimi dhe	A	0-20 milion
NP 2	Ndërtime civile dhe industriale	Mure me tullë, Struktura monolite betoni etj	A	0-20 milion
NP-4	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	Punime asfaltimi, gjurmimi, zhvendosje dherash..	A	0-20 milion
NS-1	Punime për prishjen e ndertimeve	Prishje mur tulle me pastrim	A	0-20 milion
NS-4	Punime të rifitimit..., punime metalike...	Dyer metalike + struktura e tendave	A	0-20 milion

1.3.3. Referuar preventivit, grafikut, specifikimeve teknike si dhe punimeve ndërtimore, Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi

Për drejtuesin teknik si më sipër të paraqitet :

- a) Kontrate pune;
- b) Diplome ;
- c) Libreze pune;
- d) CV ;

Operatorët ekonomik duhet të caktojë me anë të një dekaratë Drejtuesin Teknik të punimeve i cili duhet të jetë i përfshirë në license e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhedo të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, **si më sipër kërkuar.**

Argumentimi: Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm inxhinierik referuar zërave të preventivit të objektit për realizimin e kontrates në mbështetje të pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, (i ndryshuar) ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje të Nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6, gërma (c) ku specifikisht përcaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...” Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, CV apo qënësia e tyre në listpagesat e shoqërisë, janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se këta drejtues teknikë janë operativë pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtimit, topograf mjedisi dhe hidroteknik, elektrik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës

1.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** si më poshtë:

- a. 1 (Nje) Inxhinier Gjeodet
1 (Nje) Inxhinier Arkitekt
- b. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës specialist që të disponojë certifikatë e trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- c. Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmen e parë dhe nderhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jete e leshuar nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- a) **Kontrate pune;**
- b) **diplome/certificate**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, **si më sipër kërkuar.**

Argumentimi: Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm inxhinierik jo pjesë e stafit të drejtuesve teknik referuar kushteve teknike të objektit të kontratës në mbështetje të pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, (i ndryshuar) ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në ndryshuar), pika 6, gërma (c) ku specifikisht përcaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...”

AK mbështetur në VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (i ndryshuar) Lidhja 5 “Arsimet universitare përkatëse që duhet të kenë drejtuesi/it teknik” kemi kërkuar inxhinier ndërtimi infrastrukturë e transportit për arsye se gjatë ndërtimit do të ketë devijime nga rruga ekzistuese për qarkullimin e lire të mjeteve.

Në këtë rast Inxhinieri i infrastrukturës së transportit do të kalkulojë fluksin e lëvizjes së mjeteve si dhe do të llogarisë volumet e punës për segmentet e reja të rrugës në zonat ku do devijohet. Gjithashtu kërkesa për një inxhinier ndërtimi me profil gjeoteknik në dokumentat e procedurës së prokurimit i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventiv si punimet e dherave dhe të shtresave rrugore të cilat e bëjnë të nevojshme prezencën e një inxhinieri gjeoteknik gjatë ekzekutimit të kontratës. Sa më sipër sqaruar inxhinieri gjeoteknik merr pjesë në llogaritjen e uljeve dhe kohës së konsolidimit të trupit të rrugës që të konkludohet për fazën e mëtejshme sic mund të jetë vendosja e shtresave pasi çdo ulje jashtë normave të lejuara do të sillte carjen e shtresave. Kërkesa është proporcionale me objektin dhe natyrën e kontratës objekt prokurimit, volumin dhe përmasat e kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë te punësuar, punonjës të kualifikuar, të pajisur me dëshmi profesionale sipas profesioneve si më poshtë:

- 2 (nje) Teknik Ndertimi
- 1 (dy) Betonues
- 1 (nje) Karpentiere
- 1 (1) Hekurkthyes
- 1 (dy) Murator
- 1 (nje) Saldator
- 2 (dy) Punonjes per asfaltim
- 6 (dy) Punetore te thjeshte
- 1 (nje) shofer
- 2 (dy) manovratore

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë :

Kontratë punë të vlefshme, diplome/dëshmi profesionale përkatëse dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për dy muajt e fundit .Për teknikat e ndërtimit do të pranohet vetëm diploma e shkollës së mesme profesionale ose licencat përkatëse.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, **si më sipër kërkuar.**

Argumentimi: Staf i teknik i kualifikuar është kërkuar në raport me punimet që kërkohet të realizohen të cilat janë punime në trup të rrugës nga fillimi i punimeve deri në perfundim të tyre, punime gërmimi dhe mbushje punime shtresash, kanale, tombino, punime betoni, punime asfalto betoni etj. Gjithashtu ky kriter është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar) dhe neni 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

Gjithashtu për realizimin e objektit është kërkuar përdorimi i mjeteve të rënda si eskavator, autobetonire, rrula etj. Me qëllim administrimin dhe përdorimin e makinerive të rënda për punimet e ndërtimit që do të realizohen nga ana e operatorit ekonomik, si dhe disiplinimin e përdorimit të këtyre mjeteve në zbatim të rregullave të sigurimit teknik detyrimisht kërkohet një staf teknik i specializuar. Gjithashtu për realizimin e objektit janë kërkuar automjetete vetshkarkuese përdorimi i të cilave referon kërkesën për shofere të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Numri i manovratorëve dhe shoferëve është kërkuar në përpjestim me numrin e mjeteve të rënda dhe kamioneve të kërkuar për realizimin me sukses të objektit. Kriteri është vendosur në mbështetje të te pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje të Nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pika 6, gërma (c) ku specifikisht përcaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...”

- 2.3.6** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar te pakten 2 (dy) **Manovratorë**, nga tecilet 2. Për manovratorët e mjeteve të rënda, të paraqitet kontratë punë, dëshmi e drejtimit nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 2 (dy) muajt e fundit.

Për mjetet e rënda të cilat janë të marra me qera, OE duhet të paraqesë për manovratorin, kontratën e punës së vlefshme, dëshminë e drejtimit të vlefshme, lëshuar nga institucionet përkatëse, dëshmitë e drejtimit të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore, por pa qenë e nevojshme që këta manovratorë të figurojnë në listëpagesën e OE.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, **si më sipër kërkuar.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për punonjesit e kualifikuar lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve, duke krijuar besueshmërinë se kane përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar te pakten **I (dy) Shofere**, te paraqitet kontrate pune, deshmi e drejtimit nga DPSHTRR, te cilat duhet te jene te vlefshme.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, **si më sipër kërkuar.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për punonjesit e kualifikuar lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve, duke krijuar besueshmërinë se kane përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore **minimalisht 20 (njetet) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve per nje periudhe 3 mujore nga data e zhvillimit te tenderit, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 8. Operatori ekonomik krahas deklaratës, duhet te dorezoje dokumentacionin si me poshte :

- Listë pagesat e punonjësve, të konfirmuara nga institucionet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislati në fuqi.
- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, **si më sipër kërkuar**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për punonjësit e kualifikuar lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve, duke krijuar besueshmërinë se kane përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet te kete kontrate noteriale me nje laborator testimi te betonit, i cili duhet te jete i akredituar nga organizma kombetar ose nderkombetar sipas standarteve.

Detyrimisht te paraqitet kontrata noteriale.

Argumentim: Ky kriter është vendosur për të përmbushur nga ana e operatorit ekonomik çertifikimin e materialeve të ndërtimit që do të përdoren në objekt në përputhje me standartet e vendosura në specifikimet teknike të hartuara për këtë projekt.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion me vinç	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 3.5-5 ton)	2 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 cope	Pronësi ose me qera

Autobitumatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere vetngarkuese (mjet teknologjik me goma)	1 cope	Pronësi ose me qera
Ekskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	1 cope	Pronësi ose me qera

Rrul gome-gome	1 cope	Pronësi ose me qera
Mini Fadrome (mjet teknologjik me goma)	1 copë	Pronësi ose me qera
Grejder (mjet teknologjik me goma)	1 cope	Pronësi ose me qera
Fabrike asfaltbetoni e pajisur me leje mjedisore III.1.B	1 cope	Pronësi /me qera/Kontrate furnizimi noteriale
Vibrator	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 copë	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 copë	Pronësi ose me qera

- a) Për mjetet që regjistrohen ne regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikaten e pronësise, dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumentet e mesiperme duhet te shoqerohen me kontraten noteriale perkatese te qerases, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te paraqiten aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fatura tatimore perkatese dhe fotot , ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirases noteriale e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve. Për pajisjet me numrat rendorë 19, 20 duhet të paraqitet certifikatë e vlefshme e kalibrimit.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.
- d) Operatori/Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara do te angazhohen ne kete objekt prokurimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikoje dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.
- e) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Këshilli i Qarkut Tiranë (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohe dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*
- f) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu kriteri është vendosur referuar zërave të punimeve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

